

## **INFORMACION MBI DREJTORËT E DREJTORIVE TË ISHTI-T**

### **1. SUELA META - DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Znj. Suela Meta ka përfunduar studimet Bachelor në Fakultetin e Drejtësisë, në degën Drejtësi, në vitin 2009. Në vitin 2012 ka përfunduar studimet Bachelor në Fakultetin Ekonomik, në “Universitetin Fan S. Noli”, në degën Financë-Kontabilitet dhe më pas ka përfunduar studimet “Master Shkencor” në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” në vitin 2019. Znj. Meta është bërë pjesë e stafit të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial që nga Maji 2021, ku ka ushtruar funksionin e Përgjegjës të Sektorit dhe aktualisht mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme. Zotëron shumë mirë gjuhët anglisht, italisht dhe frëngjisht.

### **2. BRUXHILDA KITO - DREJTORIA E ANALIZËS, VLERËSIMIT TË RISKUT DHE MONITORIMIT**

Znj. Bruxhilda Kito është diplomuar në Fakultetin e Bujqësisë në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në vitin 2006, në degën Inxhinieri Agrare, dhe më pas ka përfunduar studimet “Postmaster” në Marrëdhënie Ndërkombëtare në Albanian University, në vitin 2011. Znj. Kito ka një eksperiencë 18 vjeçare pune dhe ka kryer disa detyra në institucione të ndryshme shtetërore. Në vazhdimësi ka ndjekur trajnime të ndryshme, fokusi i të cilave ka qenë lidhshëm, çështje të sigurisë dhe marrëdhënieve me publikun. Znj. Kito është bërë pjesë e stafit të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial që nga Janari 2020, ku ka ushtruar funksione të ndryshme, dhe aktualisht mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Analizës, Vlerësimi të Riskut dhe Monitorimit. Zotëron gjuhën italiane dhe angleze.

### **3. MEGI MYRTOLLARI - DREJTORIA E LABORATORIT QENDROR**

Znj. Megi Myrtollari ka përfunduar studimet “Bachelor” në “Bioteknologji”, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në Universitetin e Tiranës, në vitin 2014. Në vitin 2016 ka përfunduar studimet “Master I Shkencave” në “Bioteknologji Molekulare dhe Industriale” në Universitetin e Tiranës. Znj. Myrtollari është bërë pjesë e stafit të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial që në 22.01.2020, ku ka ushtruar funksionin e Specialistes së Kodifikimit në Drejtorinë e Laboratorit Qendror deri në 21.03.2024, datë që është emëruar si Përgjegjëse në Sektorin e Laboratorit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre, në Drejtorinë e Laboratorit Qendror.

Znj. Megi Myrtollari aktualisht mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Laboratorit Qendror. Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe italiane.

### **4. ARBEN TOPALLI - DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PAJISJEVE NËN PRESION**

Z. Arben Topalli ka përfunduar studimet Bachelor në Inxhinieri Mekanike, në Universitetin Politeknik të Tiranës, në vitin 2011. Në vitin 2021 ka përfunduar studimet “Master I Shkencave” në Fakultetin e Inxhinierisë, në Degën Inxhinieri Industriale me profil Inxhinieri Energjetike, në Universitetin European të Tiranës. Z. Arben Topalli është bërë pjesë e stafit të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial në 15.11.2023, ku ka ushtruar funksionin e Përgjegjës në Sektorin e Rajonit Verior- Shkodër, Lezhë, Kukës dhe Dibër në Drejtorinë e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre dhe aktualisht mban pozicionin e Drejtorit, në Drejtorinë e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion. Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe italiane.

#### **5. AMARILDO LAMAJ - DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PAJISJEVE DHE INSTALIMEVE ELEKTRIKE DHE MAKINERIVE NGRITËSE**

Z. Amarildo Lamaj ka përfunduar studimet Bachelor në Fakultetin Ekonomik dhe të Teknologjisë së Informacionit, Dega Financë-Bankë, në vitin 2014 në Universitetin European të Tiranës. Në vitin 2018 ka përfunduar studimet “Master Shkencor”, në Financë-Bankë, në profilin Banka dhe Tregje Financiare. Z. Lamaj është bërë pjesë e stafit të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial që nga Nëntori 2018, ku ka ushtruar funksionin e Inspektorit dhe aktualisht mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike dhe Makineritë Ngritëse. Zotëron shumë mirë gjuhët anglisht dhe italisht.

#### **6. AHMET SHEHU - DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE**

Z. Ahmet Shehu është diplomuar në Universitetin e Tiranës në vitin 1990, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave. Z. Shehu ka një eksperiencë 30 vjeçare pune në fushën e inxhinierisë së minierave, inspektimit dhe kontrollit cilësor në impiantet dhe instalimet e naftës dhe gazit. Z. Ahmet Shehu që nga Janari i vitit 2006 është punonjës në Inspektoratin Shtetëror të Kontrollit të Naftës dhe Gazit, më pas në 2007 ka punuar pranë Inspektoratit Qendror Teknik, dhe më pas me ristrukturimin e këtij institucioni ka kaluar si punonjës në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial, ku aktualisht mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre. Zotëron gjuhën angleze, italiane dhe greke.

#### **7. EUGEN KRISTO - DREJTORIA E SISTEMEVE TË GAZIFIKIMIT DHE IMPIANTEVE KOMBËTARE**

Z. Eugen Kristo është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës në vitin 1996, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, dega Elektronikë. Z. Kristo ka një eksperiencë 20 vjeçare pune në sektorin e inxhinierisë elektronike. Z. Eugen Kristo, në Tetor të vitit 2013 është pjesë e stafit të Inspektoratit Qendror Teknik dhe më pas me ristrukturimin e këtij institucioni ka kaluar si punonjës në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial, ku ka ushtruar funksione të ndryshme dhe aktualisht mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Inspektimit të Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse. Zotëron gjuhën angleze dhe italiane.

## **8. INVA SHABA - DREJTORIA E INFORMIMIT PUBLIK DHE KOORDINIMIT NDËRINSTITUCIONAL**

Znj. Inva Shaba ka përfunduar studimet Bachelor në Gazetari, në Universitetin e Tiranës, në vitin 2017. Në vitin 2019 ka përfunduar studimet “Master I Shkencave” në Gazetari Komunikim. Znj. Shaba është bërë pjesë e stafit të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial që nga Marsi 2021, ku ka ushtruar funksionin e Përgjegjëses në Sektorin e Rajonit Verior Shkodër, Lezhë, Kukës dhe Dibër në Drejtorinë e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare dhe aktualisht mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Informimit Publik dhe Koordinimit Ndërinstitucional. Zotëron shumë mirë gjuhën angleze.

## **9. SPARTAK SHYTAJ - DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE**

Z. Spartak shytaj ka përfunduar studimet “Master Shkencor” në Shkenca Juridike, në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, në Albanian University, në vitin 2009. Në vitin 2010 ka përfunduar studimet “Master I Shkencave” në Menaxhim Turizmi, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë. Z. Shytaj është bërë pjesë e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial në Mars 2024 si Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Juridike. Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe italiane.

## **10. SILVANA LAMAJ-DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCËS**

Znj. Silvana Lamaj është diplomuar në Universitetin e Tiranës në vitin 1989, në Fakultetin e Ekonomisë, dega e Financës. Znj. Lamaj ka kryer studimet pasuniversitare në Fakultetin Ekonomik. Znj. Silvana Lamaj ka ushtruar funksionin e saj në fushën e financës për 30 vite, në sektorin publik dhe privat. Gjatë këtyre viteve ka kryer edhe trajnime të ndryshme në fushën e financë-kontabilitetit. Është njohëse e mirë e programeve Financiare. Znj. Silvana Lamaj është bërë pjesë e stafit të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial që nga Shtatori 2019, ku ka ushtruar funksione të ndryshme, dhe aktualisht mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës. Zotëron gjuhën angleze dhe italiane.

## **11. VILMA MARA -DREJTOR, DREJTORIA E TRAJTIMIT TË AKSIDENTEVE DHE MBIKEQYRJES**

Znj. Vilma Mara ka përfunduar studimet “Master I Shkencave” në Inxhinieri Mekanike, profili Tekstil, në Universitetin Politeknik të Tiranës, në vitin 2006. Znj. Mara ka një eksperiencë të gjatë si specialiste/ kryevlerësuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, Ministria e Financës dhe Ekonomisë si dhe Menaxhere e Cilësisë në NOA CONTROL Sh.p.k. Znj. Vilma Mara është bërë pjesë e stafit të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial që nga muaji Maj i vitit 2024, ku ka ushtruar funksionin e Drejtorit në Drejtorinë e Trajtimit të Aksidenteve dhe Mbikëqyrjes, pozicion që vazhdon ta mbajë edhe sot. Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe italiane.